



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9301/2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2019 merr:

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN
JANAR-SHTATOR PËR VITIN 2019**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar -Shtator për vitin 2019.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar - Shtator 2019 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2019 është në shumë prej 2,915,921.00 €, ndërsa ai përfundimtar është 3,205,548.08 €, Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-shtator 2019 është në shumë prej 1,785,303.16 € apo 55.69 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,105,197.48 € apo 74.25 %, për mallra dhe shërbime 169,648.58 € apo 64.72 %, për shpenzime komunale 33,183.68 € apo 61.00 %, për subvencione dhe transfere 55,783.80 € apo 84.21 % dhe për shpenzime kapitale 421,489.62 € apo 31.70%. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur t'i arkëtoj gjithsejtë 241,740.21 € të hyra vetanake për periudhën janar-shtator 2019 apo 83.61 % e planit të të hyrave vetanake.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.10.2019



Kryetari i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.9572/2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, Statuti i Komunës së Hani të Elezit neni 52, Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2019 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË BIZNESIT PËR VITIN 2020 PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËR NPL "PASTRIMI" SH.A HANI I ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e biznesit për vitin 2020 Ndërmarrjen Publike Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave N.P.L "PASTRIMI" SH.A Hani i Elezit.
2. Plani i biznesit për vitin 2020 për Ndërmarrjen Publike Lokale përmban gjithsej 22 (njëzet e dy) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- N.P.L Pastrimi SH.A,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.10.2019



Kryetari i Kuvendit
MSc. Qamush Brava



01/Nr. 1958/2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2019 merr:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR ARSIMIN NË SHKOLLAT RURALE

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për themelimin e komisionit për shqyrtimin e arsimit në shkollat rurale në komunën e Hanit të Elezit, gjegjësisht shkollës fillore Seçishtë dhe Krivenik.
2. Komisioni do të jetë me këtë përbërje:
 - Rufki Suma – Kryetar i Komunës
 - Menduh Vlashi-Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
 - Qamush Brava – Kryesues i Kuvendit të Komunës.
 - Nazim Laçi-Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Ilaz Thaçi.
 - Nora Xhoni – Shefe grupit parlamentarë nga radhët e AAK-së.
 - Akif Shkreta – Shef i grupit parlamentarë nga radhët e LVV-së.
 - Mehmet Ballazhi- Shef i grupit parlamentarë nga radhët e PDK-së.
 - Mefail Suma - Shef i grupit parlamentarë nga radhët NISMA.
 - Hanumshahe Dibrani-Këshilltare e Kuvendit të Komunës nga radhët e LDK-së.
 - Teuta Shkreta- Këshilltare e Kuvendit të Komunës nga radhët e LVV-së.
 - Nehat Livoreka –Kryetar i Këshillit të Lagjes së Re.
 - Florim Shkreta-Kryetar i Këshillit të Fshatit Seçishtë.
 - Demir Thaçi- Kryetar i Këshillit të Fshatit Krivenik.
 - Ahmet Kalisi-Arsimtarë në Shkollën e Fshatit Seçishtë.
 - Hajrun Kalisi-Arsimtarë në Shkollën e Fshatit Seçishtë.
 - Isni Bushi-Kryetari i Këshillit të Prindërve.
 - Hyriete Isufi -Kryesuesi i Komitetit për Komunitete.
 - Basri Dernjani- Kryetar i Sindikatës së Arsimit në Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Ilaz Thaçi.
3. Komisioni do të mbajë takime për të diskutuar lidhur me dy shkollat në fshatin Seçishtë dhe Krivenik, pasi që numri i nxënësve është zvogëluar dhe në bazë të legjislacionit në fuqi nuk plotësohen kushtet për mbajtjen e orëve.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komisionit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.10.2019



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava